
RECENSIONE

ERWIN LEWIN: “ANTIFASCHISTISCHER WIDERSTAND IN ALBANIEN (1942-1943/1944)”, Shtëpia botuese “Rosa-Luxemburg-Stiftung Sachsen”, Leipzig, 2007, 196 f.

Libri “Qëndresa Antifashiste në Shqipëri (1942-1943/44)”. Burime të reja për aktorët dhe qëllimet”, ka për autor studiuesin gjerman Erwin Lewin. Ai ka lindur në vitin 1936. Në vitet 1956 deri 1961 ka studiuar për histori dhe albanologji në Laipzig dhe në Tiranë. Doktoroi me temën “Lëvizja për pavarësi e shqiptarëve para dhe pas Luftës së Parë Botërore” në vitin 1965. Ka punuar në Universitetin e Laipzigut dhe drejtues në Institutin për historinë e lëvizjes punëtore në Berlin. Ka botuar punimet: “Studime për historinë e Internacionales komuniste” (1974), “Historia e lëvizjes punëtore në data” (1986) etj. Vitet e fundit punon si punonjës shkencor i lirë dhe përkthyes. Ka punuar për Historinë e Lindjes dhe të pasojave të PK Shqiptare (2001), për “Aspekte historike të Lëvizjes Kombëtare të shek.XX”, si dhe për pozitën ndërkombëtare të shqiptarëve në regjimin e pasluftës (2005).

Prof. dr. Erwin Lewin ka një veprimtari të pasur studimore në fushën e historisë. Interesat studimore pasqyrohen në temat e larmishme të karakterit politik, sociologjik e historik, të cilat ai ka rrokur.

Duke pasur një formim solid e të qëndrueshëm në njohjen e organizmave ndërkombëtare që vepruan në Evropën Lindore, siç ishte Internacionalja Komuniste, ka treguar interes dhe për tematikën e problemeve të historisë shqiptare, që lidhen me to.

Ai tashmë, me këto studime për Shqipërinë radhitet në rrymën e studiuesve gjermanë që janë marrë e merren me albanologji. Për më tepër, ndihmesa për studimet e historisë shqiptare qëndron në faktin se, ai ka shfrytëzuar për studimet e tij dokumente të mirëfillta të burimit shqiptar, gjë që rrallë e kanë bërë autorë të tjerë.

Për qëndresën antifashiste në Shqipëri në vitet 1942-1943/44, prof. Lewin ka shqyrtuar dokumente historike që janë hedhur për qarkullim vetëm në vitet pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri. Kjo rrethanë i ka lejuar autorit të bëjë analiza dhe sinteza të reja, për sa i

përket aktorëve politikë shqiptarë që morën pjesë në qëndresën antifashiste, sidomos në vitet 1942-1943/44.

Krahas dokumenteve, ai ka shfrytëzuar dhe burime bibliografike të autorëve shqiptarë e të huaj, që kanë dhënë refleksione mbi probleme të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, ku një vend të veçantë ka zënë trajtimi i qëndresës antifashiste të shqiptarëve.

Përditësimi i njohurive të autorit me studimet mbi historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve gjatë shekullit XX, mbështetur në dokumente e fakte të reja, të panjohura më parë, i ka krijuar mundësinë për të ndërtuar një histori më të besueshme dhe më bindëse të qëndresës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nga mënyra e shikimit të problemeve, metoda shkencore që ka shfrytëzuar për analizën e ngjarjeve dhe rolin e figurave historike, prof. Lewin i ka dhënë lexuesit gjerman një dimension tjetër vendit dhe rolit të shqiptarëve, me përkatësi të ndryshme politike, në qëndresën antifashiste.

Libri “Qëndresa antifashiste në Shqipëri” ka një strukturë të përbërë nga tri pjesë. Në pjesën e parë në formën e një hyrje janë trajtuar në mënyrë shkencore probleme dhe ngjarje të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Midis të tjerash, autori ka bërë objekt problemet që lidhen me pushtimin fashist italian si dhe qëndresën që i bënë shqiptarët agresionit fashist. Ai ka evidentuar figura të njohura nacionaliste të kësaj qëndrese, si: të Mehdi Frashërit, me fjalimet e tij nxitëse për një qëndresë të vendosur, por edhe trimërinë e Abaz Kupit në Durrës, si dhe heroizmin e Mujo Ulqinakut. E. Lewin konfirmon në studimin e tij mendimin më të ri të historiografisë shqiptare, sipas të cilit, organizimin e parë të qëndresës kundër pushtuesit e bënë nacionalistët që krijuan çetat e para të luftës. Madje, duke iu referuar lëvizjes komuniste ai konstaton bashkëpunimin e saj me nacionalistët, si: M.Peza, M. Ujaniku, Mustafa Xhani ose Haxhi Lleshi, që në fillim të vitit 1941.

Duke u mbështetur në burime zyrtare si Historia e PKSH, ai ndalet më hollësisht në krijimin e PKSH, programin e saj, punën me nacionalistët si dhe organizimin e luftës. Për këtë i referohet Konferencës së Pezës si ngjarje, ku siç thotë ai, u formua Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar nën drejtimin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Ky i fundit mbeti një organizëm që shërbente si një mbulesë e rolit të PKSH në gjithë problemet e luftës, edhe pse raporti i përbërjes së anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Pezës, ishte në favor të nacionalistëve.

PKSH vepronte si një formacion i vetëm politik i organizuar. Si e tillë, që në fillim, ajo synonte të monopolizonte organizimin e drejtimin e luftës. Çdo ngjarje politike në Shqipëri përpiquej ta trajtonte në interes të saj. Kështu veproi ajo edhe për trajtimin e Konferencës së Pezës, duke e konsideruar atë si një fitore politike të programit të partisë.

Me një referencë të gjerë në burimet shqiptare, autori E. Lewin trajton krijimin e Ballit Kombëtar, në nëntor të vitit 1942, duke dhënë programin dhe drejtuesit më të rëndësishëm të tij. Ai thekson në punim se ata (drejtuesit e ballistët) “kanë luftuar qysh më 1939 kundër pushtimit”. Madje, autori ka dhënë dhe dy pikëpamjet e historianëve që debatojnë midis tyre për kohën e krijimit të Ballit Kombëtar, nëse u krijua që në prill 1939 apo në nëntor të vitit 1942. Ai nuk jep ndonjë version sipas bindjes së tij, por e lë debatin të hapur. Në fund të fundit, siç e pohon ai në hyrje, qëllimi i tij në botimin e 29 dokumenteve të panjohura më parë, është të nxisë debatin historiografik.

Pas analizës që iu bën programeve të forcave politike shqiptare, ai ka bërë dhe dallimin e tyre, për sa i përket synimeve, për t’u bërë forcë sunduese politike. Ai vë në dukje se parimet e rrepta organizative të PKSH në strukturat e veta, patën si rrjedhojë që, për një kohë relativisht të shkurtër, të bëhej forca udhëheqëse e FNÇ.

Autori u ka kushtuar vëmendje ngjarjeve që bëjnë fjalë për aksione të përbashkëta të nacionalistëve dhe formacioneve partizane kundër pushtuesve italianë. Edhe pse propaganda politike bëhej kundër njëra-tjetrës për çështje të konceptimit dhe të organizimit të luftës, aksionet bashkëpunuese midis tyre në luftë, u bënë shtrat i përshtatshëm që të finalizohesh ky bashkëpunim me një marrëveshje si ajo e Mukjes, në fillim të gushtit 1943.

Autori pohon në studim edhe momente politike të qëndrimit komprometues të forcave politike ndaj pushtuesit, siç është i ashtuquajturi “Protokoll nderi Dalmaco-Këlcyra” të marsit 1943. Por tashmë, ai ka sjellë dhe argumente të autorëve shqiptarë, të cilat e çojnë në përfundimin se një protokoll i tillë nuk është nënshkruar. Gjithashtu, mbështetur në dokumente e argumente të reja, ai arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me një të ashtuquajtur protokoll.

Autori i ka tërhequr vëmendjen problemi i marrëdhënies apo i konfrontimit të forcave politike shqiptare, pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes nga ana e PKSH. Për këtë ka shfrytëzuar jo vetëm dokumente, që i ka përfshirë në pjesën e dytë të këtij libri, por dhe mjaft shkrime të

autorëve shqiptarë që e kanë trajtuar këtë problem, pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri. Një ndër arsytet e konfrontimit të forcave partizane, të drejtuara nga komunistët, me ato të Ballit Kombëtar, kishte të bënte me vizionin e tyre për zgjidhjen e çështjes kombëtare, ose me fjalë të tjera me qëndrimin ndaj Shqipërisë etnike.

Ai vë në dukje se koncepti komunist për çështjen kombëtare nuk kishte lidhje me planin e pushtuesit për krijimin e “Shqipërisë së Madhe”. Mbështetur në këtë koncept, PKSHP nuk pranonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Njëherazi, duke pranuar e adaptuar pikëpamjen e PKJ, PKSHP mendonte për zgjidhjen e çështjes kombëtare pas mbarimit të luftës, me plebishit.

Sipas konceptit të PKSHP për zgjidhjen e çështjes kombëtare, konsiderohej njëlloj “Shqipëria e Madhe” e mbështetur nga propaganda e pushtuesit, me Shqipërinë etnike, sipas pikëpamjes nacionaliste shqiptare. Vënia e shenjës së barazimit midis “Shqipërisë së Madhe” dhe Shqipërisë Etnike, nga ana e PKSHP, kishte për qëllim që ajo t’i shmangej zgjidhjes së çështjes kombëtare, në rrethanat e luftës dhe më pas.

Në punimin e prof. Lewin bëhet dhe një trajtim i shkurtër i problemit të shkaqeve dhe përmasave të luftës civile në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore. Duke marrë në konsideratë dhe në shqyrtim dokumente themelore historike, siç janë dhe ato të Plenumit II të KQ të PKSHP (nëntor 1944), ai arrin të zbulojë rolin e emisarëve jugosllavë në udhëheqjen e PKSHP, për të filluar luftën civile për pushtet në rrethanat e luftës për çlirimin e vendit. Autori nxjerr përfundimin se V. Tempo ndikoi mbi Enver Hoxhën, gjatë takimit me të në gusht të vitit 1943, për ta kundërshtuar Marrëveshjen e Mukjes, të arritur nga delegacionet e dy forcave politike. Duke hedhur poshtë Marrëveshjen e Mukjes, synoheshin të arriheshin dy qëllime nga PKSHP e autorët jugosllavë. Së pari, të prishej bashkëpunimi me nacionalistët dhe për rrjedhojë të mos zgjidhej dhe çështja e Kosovës dhe bashkimit të saj me Shqipërinë. Së dyti, duke i shpallur luftë Ballit Kombëtar të arrihej vendosja e pushtetit vetëm të një force politike në Shqipëri, të drejtuara nga komunistët.

Autori pohon qartë se Marrëveshja e Mukjes dha mundësinë e bashkëpunimit midis forcave politike shqiptarë dhe kjo ishte në interes të luftës dhe të vendit.

E. Lewin mban qëndrimin e tij rreth pikëpamjeve të diskutuara mbi qëllimet e pushtimit gjerman të Shqipërisë. Përgjithësisht, ai i përmbahet pikëpamjes se qëllimi i politikës gjermane në Shqipëri ishte në përputhje

me strategjinë e saj – për sigurimin e lëndëve të para, duke mos ndërhyrë në çështjet e brendshme të administratës së ngritur pas kapitullimit të Italisë. Përgjithësisht, gjermanët u bënë mbështetje e forcave nacionaliste shqiptare në konfrontimin me komunistët, të cilët kishin shpallur luftën civile. Mbase autori duhej të merrte në konsideratë rrethanën e shpalljes së luftës civile nga PKSH, për të shpjeguar edhe raste të bashkëpunimit të ushtrisë gjermane me nacionalistët.

Ky bashkëpunim i forcave nacionaliste (përfshirë këtu dhe forcat qeveritare shqiptare) me forcat gjermane ishte një bashkëpunim i imponuar nga lufta civile që kishte shpallur PKSH për pushtet, të cilën e quante detyrë të dorës së parë. Me fjalë të tjera, ky bashkëpunim nacionalisto-gjerman ishte, në një farë mënyre, luftë për ekzistencë, kundër rrezikut të vendosjes së sundimit komunist në Shqipëri, që kërcënonte drejtpërdrejtë qënien kombëtare, duke e çuar vendin drejt një vartësie të re të huaj, ndaj Jugosllavisë.

Mendoj se për specifikat që pati vendosja e pushtuesit gjerman në Shqipëri (shpallja e pavarësisë nga Italia, krijimi i një administrate thjesht shqiptare, e cila do të merrej ekskluzivisht me administrimin e jetës së brendshme në vende, si dhe zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme të Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të saj etj.) autori mund të bënte një rivlerësim të historisë shqiptare në këtë periudhë, ndryshe nga sa na ka dhënë historiografia komuniste, të cilës i është referuar autori i këtij punimi. Roli i qeverisë shqiptare, që veprimi gjatë pushtimit gjerman të Shqipërisë, ishte në thelb neutral ndaj strategjisë gjermane të luftës, duke u nisur nga mendimi se fatet e luftës nuk përcaktoheshin nga faktori shqiptar.

Nga ana tjetër, roli i këtyre eksponentëve të politikës shqiptare në këtë periudhë historike, konsistonte në përgatitjen e terrenit të brendshëm, që, Shqipëria e pasluftës, të kishte përfaqësuesit e saj në vazhdimësinë e shtetit të pavarur shqiptar, që Shqipëria të mos bëhej terren i përshtatshëm për të kënaqur orekset e fqinjëve, të mbështetura dhe nga aleatët tradicionalë të tyre, nga Fuqitë e Mëdha.

Në pjesën e dytë të librit, autori ka dhënë 29 dokumente të rëndësishme, mbi të cilët është mbështetur në studimin hyrës të këtij libri. Dokumentet janë shoqëruar me shënime dhe informacione të shumta për ngjarjet dhe për figurat historike, të cilat përmbahen në to. Ato shënime shprehin punën këmbëngulëse të autorit, për të sjellë informacione të sakta dokumentare për lexuesin e nderuar gjerman, duke i kontribuar

studimeve të mëtejshme nga autorë të tjerë, mbi historinë e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në pjesën e tretë të librit ose të “Shtojcës”, siç e quan autori, përfshihen bibliografia e pasur dhe burimet arkivore që ka shfrytëzuar ai në përgatitjen e librit. Në këtë “shtojcë” përfshihet dhe një listë e emrave mbi figurat politike që përmenden në libër.

Për seriozitetin e parashtresës së autorit, libri merr një vlerë të spikatur historiografike për studimin e historisë së Shqipërisë, në mënyrë të veçantë, për qëndresën antifashiste të shqiptarëve gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.

Si i tillë, libri i prof. Erwin Lewin përbën një burim mjaft interesant referimi për studimet shqiptare të kësaj periudhe historike të historisë moderne.

Muharrem DEZHGIU